



LEZHË
ORTOFOTO E PËRFTUAR NGA IMAZHET SATELITORE

Publikimi në Gjeoportalin Kombëtar i Ortofotove Satelitore 2023 - 2024

Ortoimazheria nga imazhet satelitore ofron një burim të gjithanshëm dhe të vlefshëm për një gamë të gjerë aplikimesh, nga zhvillimi i infrastrukturës dhe menaxhimi i fatkeqësive natyrore, deri tek ruajtja e mjedisit dhe planifikimi i përdorimit të tokës.


Aktualisht, në Gjeoportalin Kombëtar u publikuan shtresat e mëposhtme të ortoimazherisë satelitore:

- Ortofoto Satelitore 2023
- Ortofoto Satelitore 2024
- Ortofoto Satelitore CIR 2023
- Ortofoto Satelitore CIR 2024

Këto shtresa mund të integrohen lehtësisht me hartat ekzistuese dhe sistemet e informacionit gjeografik (GIS).

Për të aksesuar këto ortofoto në Gjeoportalin Kombëtar [klikoni këtu](#).

Zgjerimi i Hartës Bazë - Qyteti i Përmetit



ASIG në cilësinë e Autoritetit Përgjegjës për temën "Imazhi i hartës bazë", si dhe në kuadër të zgjerimit të projektit fillestar të Hartës Bazë të shkallës 1:2000, ka vijuar me krijimin e hartës topografike digjitale të qytetit të Përmetit. Krijimi i kësaj harte është realizuar me anë të teknologjisë së rilevimit fotogrametrik 3D, duke mbuluar një sipërfaqe të rilevuar prej 6 km². Numri i shtresave të përdorura për këto rilevime fotogrametrike 3D arrin në 180.

Përdorimi i shërbimeve satelitore për evidentimin e ndërtesave



Bashkia Patos

Në sajë të përdorimit të metodave Deep Learning, ekspertë të ASIG, kanë realizuar identifikimin automatik të gjurmëve të ndërtesave, të cilat janë publikuar në platformën ArcGIS Online në shtresën "Ndërtesa" dhe janë të aksesueshme nga Autoritetet Publike Përgjegjëse. Kjo shtresë luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin e zhvillimit urban, duke përfshirë statistika me saktësi të lartë dhe lejon kryerjen e analizës së plotë të dinamikës së ndryshimeve urbane ndër vite.

Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit mes ASIG dhe ASHK

Në 25 shtator 2024, ASIG nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK).

Ky hap siguron shkëmbimin në kohë reale të të dhënave gjeohapësinore, jo vetëm për parcelat kadastrale dhe ndërtesat, por edhe për parcelat pyjore dhe kullotat, të cilat do të publikohen në Gjeoportalin Kombëtar. Përmirësimi dhe përditësimi i vazhdueshëm i këtyre të dhënave do të rrisë transparencën dhe aksesin për publikun e gjerë.

Kjo marrëveshje synon gjithashtu, trajnimin sistematik të stafit të ASHK për të garantuar përdorimin efektiv të të dhënave gjeohapësinore.



TRAJNIME PËR GJEONFORMACIONIN

Në kuadër të nismës së ndërmarrë nga ASIG me qëllim rritjen e kapaciteteve të 61 Njësive të Qeverisjes Vendore (NJ.Q.V.), ekspertë të ASIG kanë vijuar gjatë këtij muaji, trajnimet me stafet teknike të 10 NJ.Q.V.-ve të Republikës së Shqipërisë: Bashkia Korçë, Bashkia Kolonjë, Bashkia Maliq, Bashkia Devoll, Bashkia Pustec, Bashkia Pogradec, Bashkia Prrerjas, Bashkia Mat, Bashkia Klos dhe Bashkia Mirditë.

Tematikat e trajtuara në këto trajnime janë:

1. Njohja me funksionalitetet e Gjeoportalit Kombëtar;
2. Mbledhja e të dhënave sipas temave përkatëse të gjeoinformacionit;
3. Prezantimi i produkteve të përfutuara nga projekti i Shërbimit Satelitor.

Nisur nga interesi dhe kërkesat gjithnjë e në rritje për produktet e gjeoinformacionit, u realizua gjithashtu edhe një seancë trajnimi me stafin teknik të Agjencisë së Trajtimit të Pronave (ATP) mbi përdorimin e funksionaliteteve të Gjeoportalit Kombëtar.



Takim në kuadër të projektit JICA



Në kuadër të projektit të JICA "Mbi Ndërtimin e Kapaciteteve për Sistemin Kombëtar të Informacionit për Zjarret në Pyje (NFFIS) dhe Zgjidhjeve të bazuara në Natyrë (NbS) për Zvogëlimin e Risqeve nga Fatkeqësitë (DRR)", më 10 shtator 2024, përfaqësues të ASIG ishin pjesë e mbledhjes së parë të Komitetit të Përbashkët Koordinues (JCC).

Diskutimet përfshinë prezantimin e përgjithshëm të projektit, planin e punës dhe rezultatet e pritshme për vitin e parë, duke u arritur konsensus për veprimet e ardhshme në zbatimin e projektit në Shqipëri.

ASIG merr pjesë në simpoziunin GGHS 2024

ASIG mori pjesë në Simpoziunin EUREF 2024, i cili u zhvillua në Selanik të Greqisë, në datat 4-6 shtator 2024. Me rëndësi për përfaqësuesit e ASIG në këtë simpoziun ishte prezantimi dhe diskutimi i projekteve të Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare Moderne me ekspertët më të njohur evropianë dhe ndërkombëtarë në fushën e gjeodezisë së lartë, të cilët e vlerësuan dhe mbështetën implementimin e rrjeteve të Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare si dhe objektivat e saj në të ardhmen mbi llogaritjen e Gjeoidit Gravimetrik, bazuar në standardet evropiane dhe ndërkombëtare.



BOTA E GJEONFORMACIONIT

Satelitët e rinj Galileo shpallen tërësisht funksional

Satelitët Galileo 29 dhe 30 kanë arritur pozicionet e tyre të synuara në një lartësi prej 23,222 km dhe tashmë janë plotësisht funksional, pas një periudhe tre mujore që u lëshuan nga SpaceX në Kepin Canaveral, Florida. Këto shtesa të reja në konstelacionin Galileo janë aktive dhe ofrojnë sinjale navigimi për përdoruesit e tyre. Planifikimi për nisjen e radhës së Galileos në bordin e një SpaceX Falcon 9, është organizuar për javët e ardhshme nga Qendra Hapësinore Kennedy, në Florida.

Inteligjenca e vendndodhjes avancoon në analizën mjeko-ligjore

Disa teknologji në zhvillim po ju vinë në ndihmë ekspertëve të sigurisë publike për të dokumentuar, përpunuar dhe hetuar aksidentet rrugore. Këto teknologji kanë thjeshtuar mbledhjen e të dhënave të matura, duke ruajtur saktësinë e rrjedhës së punës së hetimit të pranuar nga gjykatat. Sektori gjeohapësinor ka përdorur satelitët për të bërë matje për një kohë të gjatë, megjithatë një adoptim më i gjerë i instrumenteve GNSS në fushën e mjekësisë ligjore dhe sigurisë publike është vënë re vetëm në pesë vjeçarin e fundit.

AKTIVITETE NË VIJIM

Smarter Data, Smarter World, on Tour 2024

Kompania "1Spatial" organizon në Birmingham, të Mbretërisë së Bashkuar, konferencën "Smarter Data, Smarter World on Tour 2024". Ky aktivitet mbledh profesionistë të industrisë së gjeoinformacionit nga e gjithë bota dhe ka në fokus Menaxhimin e Informacionit Gjeohapësinor (GeoIM) për infrastrukturën dhe sektorin e shërbimeve.

10 Tetor 2024

www.asig.gov.al

31st Workshop on Space Technology for Socio-Economic Benefits

Kombet e Bashkuara dhe Federata Ndërkombëtare Astronautike (IAF) organizojnë në Milano të Italisë, Workshopin mbi Teknologjinë Hapësinore për Përfitimet Social-Ekonomike. Qëllimi i aktivitetit është të mbledhë ekspertë nga sektori publik, privat dhe ai akademik për rritjen e ndërgjegjësimit mbi ndikimin e aktiviteteve hapësinore në mjedisin e Tokës.

11-13 Tetor 2024

GeoBuiz Summit Europe

Geospatial World organizon në Amsterdam, të Mbretërisë së Hollandës samitin GeoBuiz Europe. Ky samit është një forum unik në Evropë, që bashkon drejtues dhe përfaqësues të ekosistemit më të lartë Gjeohapësinor Evropian. Këtë vit, theksi vihet në inkurajimin e mundësive të reja të tregut, nxitjen e ndikimit ekonomik dhe forcimin e ekonomisë gjeohapësinore.

14 - 15 Nëntor 2024

www.geoportal.asig.gov.al